



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1004/2 prot.

Datë 26.04.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-98205-03-12-2024, me objekt: “Blerje artikuj ushqimor”, me fond limit 3,499,350.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25-03-2024 nga autoriteti kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve 6 - 14 vjec Shkodër.

Ankimues:

Operatori ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK me NIPT J66902033R dhe adresë Lagjia Tre Heronjt, Rruga Pal Engjelli, zona kadastrale 8593, nr pasurie 10/630, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor:

Shtëpia e Fëmijëve 6 - 14 vjec Shkodër.
Lagjia “Naim Gjylbegu”, Bulevardi “Bujar Bishanaku”, Shkodër.

Në datën 25.04.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4007, si dhe nr. protokollit 1004/2024 datë 25.04.2024, i operatorit ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-98205-03-12-2024, me objekt: “Blerje artikuj ushqimor”, me fond limit 3,499,350.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25-03-2024 nga autoriteti kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve 6 - 14 vjec Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: **b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;**”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

1-Nuk plotësoni piken 2.3.6 kapaciteti teknik I DST, pasi objektin njësi tregtare për shitjen e ushqimeve e pajisur me Leje –Higjenosanitare nuk e keni të rregjistruar si aktivitet në QKB.

2-Në formularin e Vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8 keni deklaruar si subjekt mbështetës Martin Vata, për të cilin nuk keni paraqitur një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve të DST, ku citohet si më poshtë:

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 26.04.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Gjergj Mersini

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri